



# Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

## RAPORT VJETOR 2022

Ky raport vjetor përfshin punën e bërë përgjatë vitit 2022 nga AWEN dhe organizatat anëtare në realizimin e misionit për fuqizimin e grave dhe vajzave nga pikëpamja sociale, ekonomike dhe politike, për të marrë pjesë dhe realizuar të drejtat e tyre. Puna e AWEN është e strukturuar në 4 (katër) programe tematike: Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore; Përfshirja e grave në vendimmarrje dhe në politikë; Fuqizimi ekonomik i grave; Demokratizimi, qëndrueshmëria dhe angazhimi mjedisor i OSHC-ve.

AWEN falenderon të gjithë bashkëpunëtorët për kontributin e tyre në mbështetje të grave e vajzave në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2022, si dhe shpreh mirënjohjen e thellë për punën e përkushtuar të anëtareve të rrjetit dhe të bordit, Qeverinë Suedeze – Sida, Fondacionin Sigrid Rausing Trust, Fondacionin Kvinna till Kvinna, Ambasadën e SHBA-ve - Programi i Granteve të Vogla, BE, Agjencinë Austriake për Zhvillim, që vazhdojnë të besojnë tek ne duke na mbështetur në vazhdimësi! Faleminderit!

## Programe tematike

REDUKTIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE

PËRFSHIRJA E GRAVE NË VENDIMMARRJE POLITIKË

FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE

DEMOKRATIZIMI,  
QËNDRUESHMËRIA DHE  
ANGAZHIMI MJEDISOR I OSHC-VE

# Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore

Puna e AWEN dhe organizatave anëtare të rrjetit përgjatë vitit 2022 në kuadër të këtij objektivit strategjik ka konsistuar në këto ndërhyrje:

- Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri (Sida)
- Advokimi për barazinë gjinore dhe proceset e integritimit në BE (KtK)
- Barazia Gjinore është një e drejtë! Forcimi i aktivizimit për të drejtat e grave në zonat e thella të Shqipërisë (US Embassy, Programi i Granteve të Vogla)
- Promovimi i të drejtave të grave dhe barazisë gjinore (ADA)
- Mbrojtje, promovim dhe mbështetje për përparimin e barazisë gjinore (Sigrid Rausing Trust)

## Arritjet:

- **314** aktorë lokalë janë përfshirë në aktivitete nga AWEN dhe organizatat anëtare
- **4581** gra, vajza, burra dhe djem janë sensibilizuar nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit
- Rreth **100.000** persona kanë marrë mesazhe sensibilizuese nëpërmjet medias sociale, fushatave ndërgjegjësuese, etj.
- **35** Mekanizma të referimit pranë Bashkive janë mbështetur për menaxhim rasti
- **Një** studim është realizuar lidhur me “Dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual, një analizë e situatës” (Sida)
- **1** Analizë e situatës mbi problematikat lidhur me të drejtat e grave dhe vajzave; **1** Analizë gjinore e raportit vjetor të delegacionit të Komisionit Europian; **1** Raport hulumtues mbi gratë, paqen dhe sigurinë (KtK)
- **5** fusha të reja ekspertize janë shtuar nga anëtarët e rrjetit
- **10** grante të vogla advokuese (projekte të vogla) janë kanalizuar për implementimin e nismave që variojnë nga 3 deri në 6 muaj.

## Përpjekje advokuese gjatë 2022:

- Dhënia e kontributeve për Progresin e Komisionit Europian mbi Shqipërinë
- Rishikimi i legjislacionit dytësor sa i takon çështjeve të barazisë gjinore, përfshirë procedurën, politikën dhe protokollin të cilat kanë nevojë të krijohen ose përditësohen (ADA)
- Në korrik të vitit 2022 u miratua në Parlamentin e Shqipërisë Ligji për Regjistrin e autorëve të dhunës seksuale, një nismë e ndërmarrë nga LKGV, AWEN dhe GADC.
- Advokim dhe lobim lidhur me Rezolutën 1325 (Gruaja, Paqja dhe Siguria) – AWEN ka hartuar një udhëzues për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në implementimin e agjendës “Gruaja, paqja dhe siguria”. Në këtë linjë AWEN ka organizuar trajnime dhe ngritje kapacitetesh me anëtarët e Koalicionit për Rezolutën 1325, dhe po ashtu ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe rajonale duke dhënë kontribut lidhur me çështjen.
- AWEN ka marrë pjesë dhe dhënë kontribut në sesionin e parë të hartimit të Kodit të Transmetimit si një iniciativë dhe me ftesë të Autoritetit të Mediave Audio-Vizuale mbi barazinë gjinore dhe mos-diskriminim mbi baza gjinore e cila do të përfshihet për herë të parë në Kodin e Transmetimit për Mediat Audio-Vizuale në Shqipëri.

**Ofrim i shërbimeve mbështetëse të specializuara për përfitueset, siç janë shërbimet e referimit, shërbimet psiko-sociale dhe ligjore, shërbime strehimi (emergjence ose afatgjatë), ndërhyrje ri-integruese (arsimim, formim profesional, ndërmjetësim për punësim etj.) si dhe ngritje kapacitetesh të aktorëve vendorë:**

- **5184** gra dhe vajza, viktime të dhunës në familje kanë përfituar mbështetje dhe asistencë direkte (Sida, SRT, US, ADA)
- **29** burra dhe djem kanë përfituar shërbime këshilluese/rehabilituese përmes Zyrës së Këshillimit për Djem dhe Burra (Sida)
- **359** aktorë lokal janë përfshirë në aktivitete nga AWEN dhe organizatat anëtare (Sida, SRT, US, KtK, ADA)
- **53** viktime trafikimi / të mundshme trafikimi dhe **19** fëmijë të viktimeve janë mbështetur me shërbime nga Qendra "Vatra"
- **3117** thirrje telefonike janë marrë nga Linja Kombëtare e Këshillimit dhe **3100** raste janë asistuar direkt nga këshilluesit e LKGV
- Ofrimi i shërbimeve direkte psikologjike dhe ligjore (ofruar nga profesionistë të organizatave të rrjetit) - **134** vajza, gra dhe fëmijë kanë marrë këto shërbime gjatë 2022.
- **8** seri trajnimesh në vendin e punës për punonjëset/it e Policisë së Shtetit (SRT)
- Ngritje kapacitetesh për **3** grupe informale dhe organizata të grave që punojnë në qytetin e Lushnjës, Tropojës dhe Kavajës nëpërmjet: vlerësimit të nevojave, trajnime, workshope, takime, etj. (USA)
- **6** trajnime një ditore rreth çështjeve kryesore të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave u zhvilluan në tre zonat e synuara: Tropojë, Kavajë dhe Lushnje (USA)

## Përfshirja e grave në vendimmarrje dhe politikë

AWEN në kuadër të këtij objekti strategjik është angazhuar në nisma advokuese dhe lobuese, e po ashtu hulumtime lidhur me përfshirjen e grave në pozicione vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal. Ndër të tjera:

- Janë dhënë komente dhe sugjerime për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 'Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"
- Është marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore duke dhënë kontribut dhe rekomandime konkrete
- Tryezë e rumbullakët mbi gjetjet e GREVIO-s dhe konkluzionet e Komitetit Të Palëve në Shqipëri
- Janë organizuar dy fushata kombëtare të përvitshme, Dita Ndërkombëtare e Grave dhe 16 ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore në të cilat është trajtuar përfshirja e grave dhe vajzave në vendimmarrjen qendrore dhe lokale

## Fuqizimi ekonomik i grave

### Ndërhyrjet:

- Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri (Sida)
- Mbrojtje, promovim dhe mbështetje për përparimin e barazisë gjinore (Sigrid Rausing Trust)
- Përparimi i barazisë gjinore përmes procesit të integritimit në BE (REACTOR)

### Arritjet:

- AWEN dhe anëtarët kanë ushtruar presion mbi strukturat institucionale qendrore dhe lokale lidhur me nevojën për nisma lokale për fuqizimin e grave dhe vajzave
- Kanë realizuar përpjekje advokuese lidhur me të drejtat pronësore të grave dhe vajzave mbështetur në ekspertizën e organizatave anëtare të rrjetit, LKGV dhe ShGPS
- AWEN ka kanalizuar fonde për projekte të cilat kanë fuqizuar ekonomikisht gratë dhe vajzat
- AWEN dhe organizatat anëtare kanë ofruar ndihmë dhe këshillim ligjor (parësor dhe dytësor) për gratë dhe vajzat në nevojë
- Ndërhyrjet në këtë program kanë synuar drejtpërdrejt përmirësimin dhe fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave
- AWEN ka realizuar përgjatë vitit 2022 **dy** analiza: "Statusi i grave në punësim, edukim e trajnim profesional në Shqipëri" dhe "Statusi i vajzave në STEM" (Përparimi i barazisë gjinore përmes procesit të integritimit në BE - REACTOR)

## Demokratizimi, qëndrueshmëria dhe angazhimi mjedisor i OSHC-ve

### Ndërhyrjet:

- Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grave në Shqipëri (Sida)
- Përparimi i barazisë gjinore përmes procesit të integritimit në BE (REACTOR)
- Mbrojtje, promovim dhe mbështetje për përparimin e barazisë gjinore (Sigrid Rausing Trust)

### Arritjet:

- AWEN ka mbështetur përgjatë vitit 2022 mbi **25** organizata që punojnë me të drejtat e grave dhe vajzave me asistencë teknike, monitorim dhe mentorim
- AWEN ka kanalizuar **9** grante për organizatat e rrjetit AWEN për implementimin e projekteve lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave, **10** grante të vogla për organizata jo-anëtare të rrjetit në implementimin e nismave advokuese, **6** grante në organizata të tjera partnere për implementimin e nismave monitoruese të reformave për përparimin e barazisë gjinore në procesin e integritimit në BE
- Përgjatë vitit 2022 AWEN ka organizuar dhe marrë pjesë në rrjetëzim, ngritje kapacitetesh dhe shkëmbim eksperiencash mes organizatave të rrjetit, partnere dhe organizata në rajon.

**AWEN falenderon të gjithë bashkëpunëtorët për kontributin e tyre në mbështetje të grave e vajzave në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2022!**

